



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28 Qershor 2022

Nr: 178

**VENDIM**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË SELENICË, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË  
SHQIPËRISË, ZJ. MIMOZA BAHRI JAUPAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 990 prot., datë 12.04.2022, këshilli i bashkisë Selenicë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Orlinda Pasho Muçaj, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Në bazë të nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Selenicë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 20, zj. Mimoza Bahri Jaupaj.

Me shkresën nr. 2475, prot., datë 26.05.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Selenicë, zj. Mimoza Bahri Jaupaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave



Data: 28 Qershor 2022

Nr. 178

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Selenicë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Mimoza Bahri Jaupaj

në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 34 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Mimoza Bahri Jaupaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 2688 prot., datë 13.06.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2686 prot., datë 13.06.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Mimoza Bahri Jaupaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 6277/1 prot., datë 23.06.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për zj. Mimoza Bahri Jaupaj, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 7299/1 prot., datë 17.06.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Mimoza Bahri Jaupaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Mimoza Bahri Jaupaj në këshillin e bashkisë Selenicë nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”



## V E N D O S:

1. Zj. Mimoza Bahri Jaupaj, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Selenicë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Selenicë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Mimoza Bahri Jaupaj.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

